



RAPORTI I
QËNDRUESHMËRISË

2023

keptrust.org



keptrust.org

RAPORTI I QËNDRUESHMËRISË | 2023

RAPORTI PËRFUNDIMTAR



keptrust.org

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	3
Rreth raportit	4
Mesazh nga Kryeshefi Ekzekutiv	5
1. KEP Trust në një vështrim	7
1.1. Struktura organizative dhe menaxhmenti i lartë	7
1.2. Historiku	9
1.3. Vizioni, misioni, vlerat	9
1.4. Performanca në vitin 2023	10
2. Qasja e qëndrueshmërisë	11
2.1. Strategjia dhe menaxhimi i qëndrueshmërisë	11
2.2. Analiza e materialitetit	12
2.2.1. Harta e aktiviteteve të SZHQ-së	13
3. Qeverisja Korporative	16
3.1. Parimet dhe politikat e qeverisjes korporative dhe parimet etike	16
3.2. Transparenca dhe raportimi (Auditimi i Brendshëm, Legjislacioni dhe Pajtueshmëria)	18
3.3. Qasja ndaj menaxhimit të rrezikut	19
4. Përgjegjësia sociale	21
4.1. Vlera për shoqërinë	21
4.1.1. Produktet dhe shërbimet	21
4.1.2. Përfshirja financiare	23
4.1.3. Mbrojtja e klientëve	23
4.1.4. Qasja ndaj përgjegjësisë sociale korporative	24
4.2. Vlera për punonjësit	25
4.2.1. Profili i Punonjësit	26
4.2.2. Qasja ndaj burimeve njerëzore	27
4.3. Digjitalizimi	29
5. Përgjegjësia mjedisore	31
5.1. Gjurma mjedisore	31
5.2. Vlerësimi i rrezikut mjedisor dhe social në aktivitetet e kredidhënies	32
5.3. Luftimi i ndryshimeve klimatike dhe synimet e ardhshme	33



Shkurtesat

BD: Bordi i Drejtorëve

BQK: Banka Qendrore e Kosovës

KK: Kryeshefi Komercial

KDK: Kujdesi i Duhur ndaj Klientit

KE: Kryeshefi Ekzekutiv

KF: Kryeshefi Financiar

KBNJ: Kryeshefi i Burimeve Njerëzore

M&S: Mjedisor dhe Social

BERZH: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

MSQ: Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse

GDPR: Siguria e Informacionit/Siguria Kibernetike, Mbrojtja e Të Dhënave

HOPMD: Udhëheqësi i Menaxhimi të Organizimit dhe Proceseve

ICMC: Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migrimin

IFC: Korporata Financiare Ndërkombëtare

SNRF: Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

TKP: Treguesi Kyç i Performancës

TKRr: Treguesi Kyç i Rrezikut

NJKT: Njih Klientin Tënd

NMVM: Ndërmarrje Mikro, Të Vogla dhe Të Mesme

OJQ: Organizatë Joqeveritare

SZHQ: Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm

SMSM: Sistemi i Menaxhimit Social dhe Mjedisor

Rreth raportit

Raporti i Qëndrueshmërisë i KEP Trust, i pari i këtij lloji, i cili mbulon periudhën 2021- 2023, synon të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të performancës mjedisore, sociale dhe qeverisëse (MSQ) të organizatës, duke përshkruar qëllimet e saj për qëndrueshmëri të cilat krijojnë një ndikim pozitiv në shoqëri dhe mjedis. Ky Raport i Qëndrueshmërisë ofron një pasqyrë të plotë të aspekteve mjedisore, sociale dhe qeverisëse të KEP Trust përgjatë periudhës nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2023. Raporti demonstroi përkushtimin e KEP Trust ndaj qëndrueshmërisë dhe thekson nismat e vazhdueshme në këto fusha. Për të siguruar një krahasim domethënës, janë përfshirë të dhëna nga viti 2021 deri në 2023, aty ku është e aplikueshme, për të shfaqur progresin e arritur. Objektivi kryesor i këtij raporti është të tregojë në mënyrë transparente se si KEP Trust ka përmbushur misionin e tij të qëndrueshmërisë gjatë periudhës së raportimit dhe të përshkruajë planet për përmirësimin e performancës së qëndrueshmërisë në të ardhmen. Raporti përshkruan nismat dhe strategjitë specifike të KEP Trust që do të nxisin përmirësime të mëtejme në performancën e qëndrueshmërisë në të ardhmen.

Ky raport është hartuar përgjatë një procesi të gjerë të konsultimeve me një gamë të gjerë të palëve të interesit, duke përfshirë punonjësit, klientët si NVM-të dhe bankat lokale, furnizuesit, partnerët e biznesit, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Ky proces i ka siguruar KEP Trust perspektiva të vlefshme mbi ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore në operacionet e ardhshme të KEP Trust. Informatat e mbledhura e kanë drejtuar vlerësimin material të KEP Trust, duke i ndihmuar të përcaktojnë prioritetet në fushat kritike të fokusit. Raporti përshkruan në hollësi angazhimet dhe veprimet që KEP Trust ka ndërmarrë për të dhënë një kontribut domethënës në synimet globale të qëndrueshmërisë. Në vend që të ndjekjes së një formati strikt të ndarë sipas temave si çështjet mjedisore apo sociale, informacioni përkatës është integruar në seksionet përkatëse. Në raport trajtohen ndikimet, rreziqet dhe mundësitë që kanë të bëjnë me biznesin tonë dhe partneritetet, si dhe përshkruan strategjinë tonë të qëndrueshmërisë, praktikën e menaxhimit dhe nismat specifike.

KEP Trust ju fton të jepni komente, sugjerime apo ide për përmirësimin e këtij raporti, të cilat duhet t'i drejtohen Departamentit të Menaxhimit të Organizimit dhe Proceseve përmes kepesg@keptrust.org. Ne i çmojmë komentet dhe angazhimin tuaj në përpjekjet dhe rrugëtimin tonë drejt qëndrueshmërisë.



Mesazh nga Kryeshefi Ekzekutiv

Të nderuara palë të interesit,

Derisa reflektojmë mbi rrugëtimin tonë përgjatë vitit të kaluar, me krenari të madhe paraqes raportin tonë të qëndrueshmërisë. Në KEP Trust, përkushtimi ynë për të nxitur gjithëpërfshirjen financiare dhe për të sjellë ndryshime pozitive në Kosovë mbetet i pandryshuar. Ky raport përmbledh përkushtimin tonë jo vetëm për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare inovative, por edhe për funksionimin sipas standardeve më të larta të qeverisjes korporative dhe parimeve etike.

Gama jonë e larmishme e produkteve financiare është dizajnuar me qëllim të fuqizimit të individëve dhe bizneseve të vogla, duke iu ofruar burimet e nevojshme për të lulëzuar. Ne besojmë se përfshirja financiare është një gur themeltar i zhvillimit të qëndrueshëm, dhe në mënyrë të vazhdueshme synojmë të përmirësojmë ofertat tona për t'u shërbyer më mirë klientëve tanë. Në përputhje me këtë, ne vazhduam të zgjerojmë portofolin tonë në vitin 2023 përmes shërbimeve që i ofrojmë. Aktivitetet totale të KEP Trust u rritën për 30.2%, duke arritur në 100.5 milionë EUR krahasuar me vitin paraprak.

Në përputhje me parimet tona të qeverisjes korporative, ne i japim përparësi transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizatës sonë. Vazhdimisht i kemi forcuar proceset tona të auditimit të brendshëm dhe qasjen tonë ndaj menaxhimit të rrezikut, duke siguruar që operacionet tona të jenë në përputhje me legjislacionin vendor dhe

praktikat më të mira ndërkombëtare. Strategjia jonë e qëndrueshmërisë është ndërtuar mbi bazën e marrjes së vendimeve etike, që është thelbësore për krijimin e besimit me palët tona të interesit. Duke u mbështetur në këtë bazë, që nga viti 2021, KEP Trust ka zbatuar edhe Sistemin e Menaxhimit Social dhe Mjedisor (SMSM) sipas udhëzimeve të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC). Ky sistem na mundëson të vlerësojmë rreziqet mjedisore dhe sociale në aktivitetet tona të kredidhënies, duke siguruar që rritja jonë të jetë në përputhje me synimet e qëndrueshmërisë.

Vlera që krijojmë shtrihet përtej treguesve financiarë. Përmes përkushtimit tonë ndaj përgjegjësisë sociale e korporative, ne angazhohemi në mënyrë aktive me komunitetet tona, duke mbështetur nismat që përputhen me vlerat tona. Për shembull, KEP Trust me krenari sponsorizon "Ligën e Krijuesve Kosovare", duke ofruar mjete për edukim në fushën e robotikës në shkollat publike, si dhe bashkëpunon me "Institutin ATOMI" për të mbështetur nxënësit e talentuar. Bashkëpunimet, donacionet dhe sponsorimet tona dëshmojnë përkushtimin tonë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm, ndërsa fokusi ynë në mirëqenien e punonjësve siguron që ekipi ynë të jetë i pajisur dhe i motivuar për të çuar përpara misionin tonë.

Ndërsa vazhdojmë të lundrojmë nëpër kompleksitetin e peizazhit financiar, mbetemi të përkushtuar ndaj qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. Gjurma jonë mjedisore dhe vlerësimet e rreziqeve sociale në aktivitetet e kredidhënies janë

komponente kyçe të qasjes sonë, duke siguruar që rritja jonë të mos jetë në kurriz të planetit apo komuniteteve tona. Në vitin 2024, ne planifikojmë të realizojmë një analizë të plotë të boshllëqeve dhe të vendosim objektiva të matshme MSQ për të integruar më tej qëndrueshmërinë në operacionet tona. Për më tepër, ne do të fillojmë të llogarisim dhe monitorojmë gjurmën tonë të karbonit me qëllim të minimizimit të ndikimit mjedisor.

Raporti ynë i parë i qëndrueshmërisë gjithashtu përshkruan progresin tonë në zhvillimin e kapaciteteve dhe digjitalizim, duke pranuar se fuqia punëtore e aftë dhe teknologjia moderne janë jetike për suksesin tonë. Duke investuar në punonjësit tanë dhe duke përqafuar inovacionin, ne po pozicionohemi asisoj që të përmbushim nevojat e klientëve tanë.

Unë besoj fuqishëm se së bashku, ne jo vetëm që po arrijmë sukses financiar; ne po bëjmë një ndryshim domethënës në jetën e atyre që u shërbejmë dhe në komunitetet ku jetojmë.

Në emrin tim dhe të Bordit të Drejtorëve, dëshiroj t'i falënderoj të gjitha palët tona të interesit, veçanërisht punonjësit tanë, të cilët kanë kontribuar aq shumë në performancën e KEP Trust këtë vit.

Singerisht.

Shpend NURA
Kryeshf Ekzekutiv

1. KEP Trust në një vështrim

KEP Trust u themelua në vitin 1999 nga Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migrimin (ICMC) me seli në Gjenevë dhe Klubi i Afaristëve të Prizrenit. Sot, ai përfaqëson institucionin kryesor mikrofinanciar në Kosovë, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare për klientët e vet. KEP Trust është i përkushtuar t'i ndihmojë klientët të arrijnë objektivat e tyre financiare dhe të ndërtojë marrëdhënie afatgjata, duke kontribuar kështu në mënyrë të konsiderueshme në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik të përgjithshëm të vendit. Përtej zyrës qendrore në Prishtinë, KEP Trust operon me një rrjet prej 31 degësh moderne në të gjithë vendin, duke i bërë shërbimet e tij më të qasshme për qytetarët. Misioni i Organizatës është të përmirësojë standardin e jetesës dhe të mbështesë rritjen ekonomike kombëtare përmes ofrimit të shërbimeve financiare për individë dhe biznese.

Që nga regjistrimi i tij pranë Autoritetit Bankar dhe të Pagesave në Kosovë (tani Banka Qendrore e Kosovës) në vitin 2002, KEP Trust ka funksionuar si një institucion vendor i shquar mikrofinanciar.

1.1. Struktura organizative dhe menaxhmenti i lartë

Struktura organizative e KEP Trust është dizajnuar për të promovuar parimet e qeverisjes korporative, efikasitetin operacional dhe rritjen e qëndrueshme. Korniza e qeverisjes bazohet në ndarjen e qartë të përgjegjësisë ndërmjet Bordit të Drejtorëve dhe Bordit Menaxhues, duke siguruar bashkërendimin e mirë të mbikëqyrjes strategjike dhe operacioneve të përditshme.

BD përbëhet nga pesë anëtarë të pavarur, asnjëri prej të cilëve nuk është i përfshirë në operacionet e përditshme të KEP Trust. Kjo pavarësi dhe larmi siguron një qeverisje të paanshme dhe mbikëqyrje të fuqishme. Roli kryesor i BD është të përcaktojë drejtimin strategjik afatgjatë të KEP Trust, duke u siguruar që organizata të mbetet besnike ndaj misionit dhe vlerave të saj dhe njëkohësisht të nxitë zhvillimin e qëndrueshëm.

Në përmbushjen e rolit të saj, BD përcakton dhe udhëzon strategjitë e përgjithshme të KEP Trust, duke siguruar që këto strategji të jenë në përputhje me përkushtimin e organizatës, angazhimin me palët e interesit dhe menaxhimin efektiv të rrezikut. BD gjithashtu kryen vlerësime të rregullta të performancës, jo vetëm për Bordin Menaxhues, por edhe për vetë BD-në, duke nxitur kështu një kulturë të përmirësimit dhe llogaridhënies së vazhdueshme brenda organizatës. Për më tepër, BD promovon një proces vendimmarrës gjithëpërfshirës për të siguruar që vendimet e menaxhmentit të jenë të bazuara në informata, të jenë të të balancuara dhe të pasqyrojnë interesat e ndryshme të të gjitha palëve të interesit.

Me qëllim të forcimit të strategjisë së qëndrueshmërisë, KEP Trust ka emëruar Udhëheqësin e Menaxhimit të Organizimit dhe Proceseve (UMOP) si Zyrtari për MSQ. Kjo pozitë është përgjegjëse për udhëheqjen e zbatimit të nismave të qëndrueshmërisë, duke siguruar harmonizimin me objektivat strategjike të KEP Trust nëpër departamente. Gjithashtu, Kryeshefi Financiar (KF) mbikëqyr çështjet mjedisore dhe sociale (M&S) në nivel të menaxhmentit të lartë, duke ofruar

udhëzime të nivelit të lartë si dhe duke i integruar kriteret e qëndrueshmërisë në operacionet dhe raportimet financiare.

Bordi Menaxhues, i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE), është përgjegjës për mbikëqyrjen e operacioneve të përditshme të KEP Trust dhe zbatimin e objektivave strategjike të përcaktuara nga BD. Ky ekip përfshin anëtarë kyç, si KF-në, Kryeshefin Komercial (KK), Kryeshefin e Burimeve Njerëzore (KBNJ) dhe menaxherë të tjerë të lartë, të cilët mbikëqyrin fusha kritike, si Bujqësia, NVM, Marketing, Zhvillim Biznesi, TI, Menaxhimi dhe Rrezikut dhe Burime Njerëzore. KF mbikëqyrë çështjet M&S në nivel të menaxhmentit të lartë.

Bordi Menaxhues luan një rol kritik në sigurimin e funksionimit të qetë dhe efikas të të gjitha departamenteve, duke i harmonizuar ato me objektivat strategjike të KEP Trust. BM është gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e performancës, duke udhëhequr aktivitetet e departamenteve të ndryshme për të nxitur përsosmërinë operacionale, inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Përveç kësaj, BM punon në integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë në të gjitha fushat e organizatës, nga menaxhimi financiar deri te burimet njerëzore, duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë dhe rritje të përgjegjshme.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes departamenteve rrisin efikasitetin organizativ dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimit. Në KEP Trust, burimet dhe mbështetja ofrohen në të gjitha nivelet, nga menaxhmenti deri te operacionet në terren, me qëllim të maksimalizimit të aftësive të punonjësve. Kjo qasje jo vetëm se nxit zhvillimin profesional të stafit, por gjithashtu siguron ofrimin e shërbimeve efektive dhe me cilësi të lartë për klientët tanë.

Bordi i Drejtorëve i KEP Trust është i ngarkuar me miratimin e një strukture organizative që përputhet me natyrën operacionale të Organizatës, duke siguruar rregulloret e duhura organizative për zbatimin e strategjisë së miratuar nga Bordi. Kjo strukturë është dizajnuar me qëllim të promovimit të vendimmarrjes efektive dhe të zbatimit të praktikave më të mira të qeverisjes.

Elementet kyç të kësaj strukture përfshijnë:

- Një kornizë organizative të qartë dhe transparente.
- Synime specifike të përcaktuara për secilën njësi administrative.
- Detyra dhe përgjegjësi funksionale të përcaktuara qartë për secilën njësi administrative.
- Autoritete, kanale komunikimi dhe linja të drejtpërdrejta të mbikëqyrjes të përcaktuara për pozitat në të gjitha nivelet menaxheriale, duke mundësuar mbikëqyrje të dyfishtë që ekuilibron rolet e Bordit dhe Menaxhmentit Ekzekutiv, së bashku me shpërndarjen dhe ndarjen e duhur të përgjegjësisë.
- Evidencë, politika dhe procedura gjithëpërfshirëse për të mbështetur ekzekutimin dhe mbikëqyrjen operacionale, të shoqëruara me përshkrime të punës për të gjitha nivelet brenda strukturës organizative, ku përcaktohen kualifikimet dhe përvoja e kërkuar për secilën pozitë.
- Sigurimin që struktura jonë organizative mbështetë dhe përforcon plotësisht praktikën e mira të qeverisjes.
- Zyrtari i MSQ do të punojë ngushtë me ekipet e Rrezikut, Auditimit dhe Pajtueshmërisë për të menaxhuar dhe trajtuar në mënyrë proaktive rreziqet dhe mundësitë që ndërlidhen me qëndrueshmërinë.

1.2. Historiku



1.3. Vizioni, misioni, vlerat


Vizioni, misioni dhe vlerat e KEP Trust janë të përqendruara në përmirësimin e standardit të jetesës dhe përkrahjes së zhvillimit ekonomik të Kosovës. Misioni i KEP Trust është të ofrojë shërbime financiare për individë dhe biznese, për t'i ndihmuar ata në arritjen e këtyre synimeve. Rëndësia e ndërtimit të marrëdhënieve të vazhdueshme me klientët është e theksuar dhe kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. KEP Trust gjithashtu ka një mision të fuqishëm social, që synon zvogëlimin e varfërisë në mesin e komuniteteve, duke i mbështetur ata që kanë qasje të kufizuara në burimet financiare.

Si pjesë e përkushtimit në rritje ndaj qëndrueshmërisë, KEP Trust ka zgjeruar misionin e tij për të trajtuar sfidat mjedisore urgjente. Organizata tani integron në mënyrë aktive parimet MSQ në strategjinë e saj, me objektiva të qarta për rritje të përgjegjshme dhe efikasitet në shfrytëzimin e burimeve. Strategjia jonë e qëndrueshmërisë përfshin nisma për zvogëlimin e gjurmëve mjedisore të vetë KEP Trust dhe për mbështetjen e klientëve në miratimin e praktikave të qëndrueshme përmes produkteve financiare të përshtatura, siç janë kreditë e gjelbra.

Me zhvillimin e kësaj qasjeje ndaj qëndrueshmërisë, KEP Trust synon të arrijë caqe të matshme MSQ në vitin 2024, përfshirë zvogëlimin e gjurmës të veta të karbonit dhe përmirësimin e monitorimit të rreziqeve mjedisore që ndërlidhen me aktivitetet e kredidhënies. Këto përpjekje janë në përputhje me misionin tonë bazë dhe pasqyrojnë përkushtimin tonë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm dhe pozitiv në komunitetet të cilave ne u shërbejmë.

1.4. Performanca në vitin 2023

Në vitin 2023, KEP Trust ka përjetuar rritje të konsiderueshme financiare. Totali i aktiveve u rritë për 30.2%, duke arritur në 100.5 milionë EUR krahasuar me vitin paraprak. Kreditë për klientët, pas llogaritjes së provizioneve për humbjet, përbënin 88.3% të aktiveve totale. Më 31 dhjetor 2023, totali i kredive bruto ishte rritur për 26.5%, duke arritur në 91.3 milionë EUR. Provizionimi për humbjet nga kreditë gjithashtu u rrit për 33.8%, duke theksuar përkushtimin e IMF-së për ruajtjen e një portofoli solid dhe të qëndrueshëm në përputhje me SNRF 9.



Detyrimet e KEP-it nga huamarrjet u rritën në 67.5 milionë EUR, një rritje prej 37.4% pavarësisht pasigurive ekonomike globale. Teprica arriti në 30.5 milionë EUR, ku përfshihen 3.8 milionë EUR të fituara nga aktiviteti ekonomik gjatë vitit. Të ardhurat neto pas tatimit ishin 3.8 milionë EUR, një rritje e lehtë prej 0.14 milionë EUR nga viti paraprak. Interesi nga kreditë mbeti burimi kryesor i të ardhurave totale të KEP Trust.

Më 31 dhjetor 2023, shpenzimet e personelit arritën në 4.1 milionë EUR, duke pasqyruar një rritje prej 6.8% nga viti paraprak. Kjo rritje erdhi si rezultat i përshtatjeve të kompensimit për shkak të inflacionit dhe investimeve në trajnim dhe zhvillim, të cilat janë me rëndësi vendimtare për rritjen dhe përparimin e ekipit. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, duke përjashtuar provizionet, arritën në 2.6 milionë EUR, duke shënuar kështu një rritje prej 18% nga viti paraprak. Megjithatë, raporti i të ardhurave neto ndaj shpenzimeve të përgjithshme, duke përjashtuar provizionet për humbjet nga kreditë, mbeti i qëndrueshëm nën 60%, që dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të KEP Trust për menaxhimin e shpenzimeve.

2. Qasja e qëndrueshmërisë

2.1. Strategjia dhe menaxhimi i qëndrueshmërisë

Gjatë vitit 2023, KEP Trust u përqendrua në kuptimin e pozicionit të tij aktual lidhur me qëndrueshmërinë, duke vlerësuar praktikat ekzistuese dhe duke hapur rrugën për përmirësimet e ardhshme. Aktualisht, KEP Trust është duke punuar në zhvillimin e një kornize gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë që synon integrimin e parimeve MSQ në të gjitha aktivitetet e saj operacionale. Edhe pse është duke u përgatitur një strategji formale e qëndrueshmërisë, KEP Trust tashmë ka ndërmarrë masa të rëndësishme për zbutjen e rreziqeve mjedisore dhe sociale, duke vendosur kështu themelet për një qasje më gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë në vitet në vijim.

Në strukturën aktuale organizative, përgjegjësia për mbikëqyrjen dhe zbatimin e nismave të qëndrueshmërisë brenda KEP Trust i përket UMOP-së, siç është shpjeguar në seksionin 1.1. KEP Trust ka krijuar tashmë një Sistem të Menaxhimit Social dhe Mjedisor (SMSM) në vitin 2021, duke u bazuar në udhëzimet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC). SMSM-ja përcakton parimet dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve M&S që kanë të bëjnë me aktivitetet e kredidhënies së KEP Trust. Një komponent kyç i menaxhimit të qëndrueshmërisë së KEP Trust është Politika dhe Procedura e SMSM, e cila përcakton detyrat, përgjegjësitë dhe proceset për menaxhimin e rreziqeve M&S në kuadër të organizatës. Kjo politikë përfshin një sistem të qartë të kategorizimit për vlerësimin e niveleve të rrezikut:

- Kategoria A: Rrezik i lartë
- Kategoria B: Rrezik i mesëm
- Kategoria C: Rrezik i ulët
- Kategoria D: Ndikim pozitiv

Ky sistem siguron që të gjitha aktivitetet e kredidhënies t'i nënshtrohen një procesi të plotë të rishikimit dhe kategorizimit, me qëllim vlerësimin e ndikimit të tyre të mundshëm në çështjet M&S. Në përputhje me standardet e përcaktuara nga IFC, KEP Trust ka zbatuar gjithashtu një Listë Përrjashtuese, e cila përcakton aktivitetet që nuk do të financohen për shkak të rreziqeve që bartin ndaj aspekteve sociale dhe mjedisore. Procedura e SMSM-së përcakton që vlerësimi i rrezikut M&S duhet të kryhet për të gjitha kreditë, pa marrë parasysh shumën.

Megjithëse strategjia e qëndrueshmërisë është ende në zhvillim, KEP Trust është shumë e përkushtuar ndaj këtyre veprimeve themelore:

- KEP Trust do ta fillojë zyrtarisht rrugëtimin e vet të qëndrueshmërisë në vitin 2024, duke kryer një analizë gjithëpërfshirëse të hendekut, e cila do të identifikojë fushat ku operacionet, praktikat e kredidhënies dhe strukturat e qeverisjes së institucionit kanë nevojë për përmirësime për të përmbushur standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë.
- Deri në fund të vitit 2024, KEP Trust do të përfundojë hartimin e strategjisë së qëndrueshmërisë, e cila do të përcaktojë caqe specifike dhe të matshme MSQ.
- KEP Trust do të forcojë praktikat e kredidhënies duke integruar kriteret MSQ, duke siguruar kështu rritje të përgjegjshme dhe respektim të standardeve M&S.
- KEP Trust do të fillojë llogaritjen e gjurmëve të karbonit nga operacionet e veta dhe do të vendosë kufij për emetimet si pjesë e përkushtimit më të gjerë ndaj qëndrueshmërisë mjedisore.
- KEP Trust do të angazhohet me palët e interesit përmes komunikimit transparent dhe nismave të dizajnuara për të mbështetur praktikat e qëndrueshme.

2.2. Analiza e materialitetit

Është me rëndësi të jashtëzakonshme që të kuptohen prioritetet dhe shqetësimet e palëve të interesit, në mënyrë që të hartohet një udhërrëfyes efektiv dhe i përshtatshëm i qëndrueshmërisë. Analiza e materialitetit e KEP Trust i mundëson organizatës të identifikojë çështjet e qëndrueshmërisë që kanë rëndësinë më të madhe si për palët e brendshme të interesit, ashtu edhe për ato të jashtme. Duke u përqendruar në këto çështje kyç, KEP Trust siguron që përpjekjet e saj janë në përputhje me pritshmëritë e palëve të saj të interesit, kërkesat e legjislacionit përkatës dhe vizionin afatgjatë të KEP Trust për qëndrueshmërinë. Procesi i analizës së materialitetit u zhvillua në tre hapa të strukturuar, për të siguruar kuptimin e plotë të shqetësimeve lidhur me qëndrueshmërinë.

Identifikimi i temave kyç të qëndrueshmërisë është aspekt themelor dhe parësor analizës. Një listë gjithëpërfshirëse e temave të qëndrueshmërisë është zhvilluar përmes një procesi të krahasimit me kompani të ngjashme në sektorin mikrofinanciar. Hapi tjetër ishte angazhimi me palët e interesit. KEP Trust ka kontaktuar një numër palësh të interesit, të cilat përfaqësonin si grupet e brendshme (punonjësit, menaxhmenti) të interesit ashtu edhe ato të jashtme (klientët, rregullatorët, partnerët). Nga palët e sipërpërmendura të interesit u kërkua të vlerësonin me pikë një sërë temash të qëndrueshmërisë, duke ofruar kështu kontribut të pazëvendësueshëm për analizën pasuese. Më në fund, përgjigjet nga anketa iu nënshtruan analizës dhe u vendosën në një matricë të materialitetit, duke i mundësuar kështu KEP Trust të vizualizojë rëndësinë e secilës temë nga këndvështrimi i brendshëm dhe i jashtëm.

Më pas, temat janë klasifikuar në dy nivele prioritetesh:


Prioritet shumë i lartë:

- Mirëqenia e punonjësve dhe mjedisi i shëndetshëm i punës
- Zhvillimi i punonjësve
- Ndikimi pozitiv social

Prioritet i lartë:

- Gjithëpërfshirja financiare dhe zhvillimi i kapaciteteve
- Pajtueshmëria rregullative
- Marrëdhëniet me palët e interesit
- Anti-korrupsioni dhe etika në biznes
- Digjitalizimi dhe inovacioni
- Performanca e qëndrueshme financiare
- Shumëllojshmëria dhe gjithëpërfshirja
- Menaxhimi mjedisor
- Ndryshimet klimatike
- Prokurimi dhe kontraktimi i jashtëm i përgjegjshëm

Matrica e materialitetit ofron një paraqitje vizuale të këtyre prioriteteve, ku vlerësimet e palëve të brendshme të interesit shfaqen në boshtin horizontal dhe ato të palëve të jashtme të interesit në boshtin vertikal. Kjo matricë ndihmon KEP Trust të përqendrojë burimet dhe përpjekjet në fushat që konsiderohen më të rëndësishme si për operacionet, ashtu edhe për pritshmëritë e palëve të interesit, duke siguruar që strategjia e qëndrueshmërisë së organizatës të trajtojë çështjet më të rëndësishme.



2.2.1. Harta e aktiviteteve të SZHQ-së

Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SZHQ) të Kombeve të Bashkuara, të vendosura në vitin 2015, paraqesin një thirrje universale për veprim që synon çrrënjosjen e varfërisë, mbrojtjen e planetit dhe sigurimin e paqes dhe begatisë për të gjithë njerëzit deri në vitin 2030. Të 17 Synimet e ndërlidhura ofrojnë një kornizë për adresimin e sfidave më urgjente globale, duke përfshirë ndryshimet klimatike, pabarazitë ekonomike, konsumimin e qëndrueshëm dhe ndërtimin e paqes.

Për bizneset, harmonizimi me SZHQ-të nuk është vetëm çështje e përgjegjësisë sociale, por edhe një mundësi për të nxitur vlerën afatgjatë duke kontribuar në agjendën globale. Inkorporimi i SZHQ-ve në strategjitë korporative u mundëson bizneseve që të ndihmojnë në zhvillimin e ekonomive të qëndrueshme, në forcimin e kohezionit midis komuniteteve dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo, nga ana tjetër, iu mundëson bizneseve të përmirësojnë qëndrueshmërinë e tyre dhe rritjen afatgjatë.

Në KEP Trust, respektimi i SZHQ-ve është thelbësor për të siguruar që vizioni dhe misioni afatgjatë i organizatës janë në përputhje me përpjekjet globale për qëndrueshmëri. Në përputhje me gjetjet e analizës së materialitetit dhe në përputhje me vlerat themelore të KEP Trust, SZHQ-të e mëposhtme janë identifikuar si fusha prioritare për aktivitetet e ardhshme të organizatës. Këto synime ofrojnë një kornizë për rrugëtimin e qëndrueshmërisë së KEP Trust, duke i mundësuar institucionit të përqendrojë përpjekjet e tij në fushat me ndikimin më të madh të operacioneve të saj dhe në marrëdhëniet me palët e interesit.



SZHQ 5: Barazia gjinore

KEP Trust është i përkushtuar në promovimin e barazisë gjinore, që është një aspekt thelbësor për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Si pjesë e këtij përkushtimi, KEP Trust ka ndarë të paktën 30% të fondeve nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Ndërmarrjet Mikro, Të Vogla dhe Të Mesme (NMVM) të drejtuara nga gratë, duke siguruar kështu qasje më të madhe në shërbimet financiare për gratë ndërmarrëse. Për më tepër, KEP Trust i kushton rëndësi të madhe ruajtjes së ekuilibrit gjinor brenda fuqisë punëtore të vet.



SZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike

Objektivi i KEP Trust është të lehtësojë rritjen e qëndrueshme ekonomike duke ofruar qasje në shërbime financiare që krijojnë mundësi punësimi dhe mbështesin zhvillimin e bizneseve të vogla. Duke vazhduar investimet në teknologji, modernizimin e degëve dhe zhvillimin e stafit, KEP Trust është në gjendje t'u përgjigjet nevojave në evolucion të klientëve të vet, duke kontribuar njëkohësisht në stabilitetin më të gjerë ekonomik.



SZHQ 10: Zvogëlimi i pabarazive

Gjithëpërfshirja është një parim themelor i vlerave organizative të KEP Trust. Duke përfshirë SZHQ 10 në kornizën operacionale, KEP Trust synon të zvogëlojë pabarazitë sociale dhe ekonomike, duke garantuar qasje të barabartë në shërbime financiare për të gjithë individët, pavarësisht gjinisë, racës apo statusit socio-ekonomik. Ky objektivi pasqyrohet në Politikën e Burimeve Njerëzore dhe në përpjekjet e vazhdueshme për të promovuar diversitetin dhe përfshirjen.



SZHQ 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

Objektivi i përgjithshëm i KEP Trust është promovimi i krijimit të komuniteteve urbane të qëndrueshme dhe rezistente. Kjo arrihet duke përmirësuar qasjen në shërbime financiare të përballueshme. Ky përkushtim shërben për fuqizimin e popullsisë me qasje të kufizuara në financa, duke u mundësuar të arrijnë siguri dhe qëndrueshmëri ekonomike, ndërkohë që forcon rolin e KEP Trust në nxitjen e përgjegjësisë sociale.



SZHQ 13: Veprimi klimatik

Në pajtim me SZHQ 13, KEP Trust është i përkushtuar në përballimin e sfidave që paraqiten nga ndryshimet klimatike përmes zbatimit të praktikave të qëndrueshme të kredidhënies dhe efikasitetit operacional. Institucioni ka përcaktuar objektiva klimatike dhe ka integruar vlerësimet e rreziqeve M&S në SMSM e tij, me qëllim të zbutjes së ndikimit mjedisor të portofolit të kredive dhe operacioneve të tij.



SZHQ 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta

KEP Trust afirmon rëndësinë e institucioneve funksionale që nxisin paqen, drejtësinë dhe transparencën. Duke nxitur marrëdhënie bashkëpunuese me organizata kombëtare dhe duke mbështetur nismat e orientuara drejt komunitetit, KEP Trust luan një rol aktiv në promovimin e qeverisjes së mirë dhe stabilitetit social. Për më tepër, organizata është e përkushtuar të ruajë një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe etik, që pasqyron këto vlera.

3. Qeverisja Korporative

3.1. Parimet dhe politikat e qeverisjes korporative dhe parimet etike

Qasja e qeverisjes korporative e miratuar nga KEP Trust dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm për respektimin e standardeve të larta të qeverisjes korporative dhe sjelljes etike. Këto parime konsiderohen themelore për ndërtimin e besimit të palëve të interesit, arritjen e suksesit afatgjatë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Korniza e qeverisjes së KEP Trust thekson transparencën, përgjegjësinë dhe drejtësinë, duke udhëhequr vendimet strategjike të organizatës dhe operacionet e përditshme, si dhe duke siguruar pajtueshmëri me standardet ligjore dhe etike në përputhje me misionin e saj.

Parimet e qeverisjes korporative të KEP Trust

Transparenca dhe shpalosja e informacionit	Llogaridhënia	Drejtësia dhe trajtimi i barabartë
<p>KEP Trust është i përkushtuar të sigurojë transparencë duke ofruar në mënyrë të vazhdueshme informacion të saktë dhe me kohë për performancën e tij financiare dhe operacionale. Kjo arrihet përmes një sistemi gjithëpërfshirës të raportimit që përfshin raporte vjetore të detajuara, deklarata të ndërmjetme dhe përditësime për aktivitetet kryesore. Përveç kësaj, kanalet e hapura të komunikimit lejojnë palët e interesit të kenë qasje në këtë informacion, duke promovuar një atmosferë besimi dhe qartësie.</p>	<p>Llogaridhënia është thelbësore që KEP Trust të operojë në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrojnë në përputhje me misionin dhe vlerat e tij. Vlerësimet e rregullta të performancës së Bordit të Drejtorëve dhe Bordit Menaxhues kryhen për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Këto vlerësime forcojnë kornizën e llogaridhënies, duke siguruar që veprimet e lidershit të jenë gjithmonë në përputhje me objektivat strategjike të organizatës.</p>	<p>KEP Trust është i përkushtuar të trajtojë të gjitha palët e interesit me drejtësi dhe të sigurojë që proceset vendimmarrëse të jenë të barabarta. Institucioni ka mekanizma për zgjidhjen e konflikteve të interesit, duke siguruar paanshmëri në operacionet e veta. Ky përkushtim shtrihet te të gjitha palët e interesit, duke përforcuar dedikimin e organizatës ndaj barazisë dhe drejtësisë.</p>
Pajtueshmëria ligjore dhe sjellja etike	Struktura dhe përbërja e Bordit	Mbikëqyrja strategjike
<p>Pajtueshmëria me kërkesat ligjore dhe rregullatore është një aspekt themelor i operacioneve të KEP Trust. KEP Trust siguron që të gjitha praktikatat të jenë në përputhje me detyrimet ligjore. Një element kyç i kësaj kornize është Kodi i Etikës, i cili udhëzon sjelljen e të gjithë punonjësve, duke promovuar integritetin dhe marrjen e vendimeve etike në gjithë organizatën. KEP Trust synon të ruajë standardet më të larta të sjelljes, duke kultivuar një kulturë respekti dhe integriteti në të gjitha fushat e institucionit.</p>	<p>Bordi i KEP Trust përbëhet nga individë me aftësi, përvoja dhe kualifikime të larmishme, të cilat e përmirësojnë cilësinë e vendimmarrjes dhe sigurojnë marrjen në konsideratë të një sërë perspektivash. Kjo larmi forcon qeverisjen, duke siguruar përfaqësimin e interesave të të gjitha palëve të interesit. Për më tepër, gjithëpërfshirja e anëtarëve të pavarur të Bordit siguron mbikëqyrje të paanshme, duke kontribuar kështu në një qeverisje të balancuar dhe objektive.</p>	<p>Përcaktimi i drejtimit strategjik është vendimtar për të siguruar që objektivat e KEP Trust janë në përputhje me misionin dhe vlerat e tij. Kjo mbikëqyrje promovon rritje të qëndrueshme dhe të përgjegjshme, duke siguruar funksionimin pa pengesa të institucionit. Menaxhimi efektiv i rrezikut është një aspekt kyç i mbikëqyrjes strategjike, që përfshin identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve. Praktikatat e forta të menaxhimit të rrezikut mbrojnë aktivitetet dhe reputacionin e KEP Trust, duke siguruar qëndrueshmëri dhe sukses afatgjatë.</p>

Kontrollet e brendshme	Angazhimi i palëve të interesit	Lidershipi etik dhe kultura
<p>KEP Trust aplikon sisteme të fuqishme kontrolli të brendshëm, duke siguruar përputhshmëri dhe efikasitet operacional. Aktivitetet e rregullta të kontrollit të brendshëm dhe auditimet e brendshme kryhen me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit si të standardeve të pajtueshmërisë, ashtu edhe të objektivave të performancës. Këto auditime ndihmojnë në mbajtjen e llogaridhënies dhe sigurojnë që të gjitha proceset të jenë në përputhje me objektivat e organizatës dhe kërkesat rregullative.</p>	<p>Megjithëse operon si një Organizatë Joqeveritare (OJQ) pa aksionarë, KEP Trust angazhohet në mënyrë proaktive me një gamë të larmishme të palëve të interesit, përfshirë huadhënësit, përfituesit dhe partnerët. Organizata i jep rëndësi të madhe kontributit të palëve të interesit dhe siguron që interesat e tyre të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes. Ky angazhim është komponent thelbësor i kornizës së qeverisjes së institucionit, duke siguruar që palët e interesit të jenë të informuara dhe që komentet e tyre merren seriozisht.</p>	<p>KEP Trust kultivon një kulturë organizative që mishëron lidershipin etik, ku ekipi menaxhues shërben si model dhe vendos një standard të lartë të sjelljes në të gjithë institucionin. Një lidership i tillë etik është jetik për krijimin e një mjedisi të punës që karakterizohet nga integriteti. Institucioni përpiqet të integrojë këto vlera në të gjitha nivelet, duke siguruar kështu që ato të pasqyrohen në operacionet dhe vendimmarrjen e përditshme.</p>

Për të garantuar zbatimin efektiv të parimeve të qeverisjes korporative, KEP Trust ka krijuar një grup gjithëpërfshirës të dokumenteve të brendshme. Disa nga politikat kyç përfshijnë:

- Politika e burimeve njerëzore
- Kodi i sjelljes
- Politika e prokurimit
- Politika për rrezikun kreditor
- Politika e menaxhimit të rrezikut
- Politika e rrezikut operativ
- Politika e kontrollit të brendshëm
- Politika për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale
- Procedurat e parandalimit të mashtrimit, ryshfetit, korrupsionit dhe sinjalizimit
- Politika për teknologjinë e informacionit

Këto politika rishikohen dhe përditësohen rregullisht për t'u siguruar se janë të përshtatshme dhe efektive, duke pasqyruar përkushtimin e KEP Trust ndaj përmirësimit të vazhdueshëm. Programet e rregullta të trajnimit dhe zhvillimit e mbajnë menaxhmentin dhe stafin të informuar për standardet më të fundit të qeverisjes, duke u mundësuar atyre të zbatojnë praktikatat më të mira në zhvillim. Parimet etike të KEP Trust janë dizajnuar në atë mënyrë që të zbatohen standardet më të larta të integritetit, duke siguruar që Organizata të veprojë me respekt për të gjitha palët e interesit dhe të ruajë një kulturë etike të sjelljes. Këto parime janë integruar në kulturën e Organizatës, duke ndikuar në proceset vendimmarrëse dhe duke udhëhequr veprimet e përditshme. Kodi i Sjelljes në fuqi përcakton standardet e pritura të sjelljes etike. Ky Kod ofron udhëzime se si të

qasemi ndaj vendimmarrjes etike dhe si të trajtohen dilemat etike në atë mënyrë që është në përputhje me vlerat e Organizatës. Ky Kod shërben si pika kryesore e referimit, duke siguruar që veprimet në të gjitha nivelet e institucionit të pasqyrojnë integritet dhe profesionalizëm. Është kërkesë që të gjithë punonjësit ta nënshkruajnë Kodin e Sjelljes çdo vit, duke konfirmuar se e kanë lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e tij.

Procedura disiplinore zbatohet për të gjithë punonjësit e KEP Trust dhe është projektuar për të siguruar drejtësi dhe qëndrueshmëri në çështjet disiplinore. Kjo procedurë përcakton një gamë rregullash, masash ndëshkuese dhe veprimesh që do të ndërmerren në rastet kur punonjësit nuk arrijnë nivelin e pritur të standardeve profesionale dhe performancës, siç përcaktohen nga politikat dhe procedurat e KEP Trust. Procedura gjithashtu siguron që të gjithë punonjësit të jenë mjaftueshëm të informuar mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me masat disiplinore në vendin e punës. Kjo procedurë përmbush detyrimet ligjore që burojnë nga ligjet në fuqi në Kosovë, e në veçanti nga Ligji i Punës.

3.2. Transparenca dhe raportimi (Auditimi i Brendshëm, Legjislacioni dhe Pajtueshmëria)

KEP Trust është këmbëngulës në përkushtimin e tij ndaj transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha operacionet. Ky përkushtim ruhet përmes zbatimit të proceseve solide të auditimit të brendshëm dhe një kornize gjithëpërfshirëse ligjore e të pajtueshmërisë, duke siguruar që institucioni i respekton si standardet e brendshme, ashtu edhe detyrimeve ligjore të jashtme.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm i KEP Trust ruan integritetin e operacioneve të organizatës. Një nga përgjegjësitë e tij kryesore është realizimi i auditimeve të rregullta të politikave thelbësore për të siguruar pajtueshmëri dhe efikasitet operacional. Departamenti përdor një metodologji planifikimi të auditimit të bazuar në rrezik, e cila përqendrohet në vlerësimin e rregullt të fushave më kritike të organizatës, duke mundësuar mbikëqyrje gjithëpërfshirëse atje ku është më e nevojshme.

Në vitin 2023, si pjesë e rishikimit vjetor, Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka audituar Kodin e Sjelljes dhe Procedurën e Parandalimit të Mashtrimit. Gjatë këtij auditimi u identifikua një mundësi për përmirësim. U rekomandua që të gjithë punonjësit të kryejnë trajnime shtesë, për të forcuar aftësitë e tyre për të identifikuar dhe raportuar shqetësimet ose keqpërdorimet e mundshme. Ky rekomandim u zbatua shpejt, duke forcuar kontrollet e brendshme të KEP Trust

dhe duke e rrënjësuar më tej kulturën e integritetit dhe llogaridhënies në të gjithë organizatën.

Në aspektin e pajtueshmërisë, të gjitha ligjet dhe rregulloret në Kosovë respektohen me përpikëri. Raportimi bëhet çdo tre muaj për të përditësuar me informata menaxhmentin dhe Komitetin e Rrezikut të Bordit të Drejtorëve. Për më tepër, njoftimet dhe raportet lidhur me legjislacionin e ri dërgohen rregullisht te menaxhmenti dhe Komiteti i Rrezikut (KRR).

Pajtueshmëria me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullative arrihet përmes Politikës Ligjore dhe të Pajtueshmërisë, e cila siguron që të gjitha praktikat të jenë në përputhje si me kërkesat kombëtare, ashtu edhe me ato ndërkombëtare. Kjo politikë përcakton kornizën për respektimin rigoroz të standardeve ligjore nga KEP Trust, duke garantuar që të gjitha aktivitetet kryhen në mënyrë të përgjegjshme dhe në pajtim të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përveç kësaj, KEP Trust zbaton Politikën gjithëpërfshirëse për Trajtimin e Ankesave, e cila ofron një mekanizëm të hapur për palët e interesit, duke përfshirë klientët, punonjësit dhe partnerët, për të shprehur shqetësimet e tyre. Kjo politikë siguron trajtimin e të gjitha ankesave në mënyrë të drejtë, të shpejtë dhe efikase. Duke pasur një proces të qartë dhe të qasshëm për menaxhimin e ankesave, KEP Trust nxit besimin dhe forcon marrëdhëniet me klientët, duke përmirësuar vazhdimisht transparencën dhe llogaridhënien operacionale.

Gjatë vitit 2023, Departamenti Ligjor i KEP Trust vijoi me monitorimin e vazhdueshëm dhe siguroi informimin e menaxhmentit dhe komiteteve të rrezikut për çdo përditësim ligjor, përfshirë ato në lidhje me çështjet MSQ. Në përputhje me rëndësinë në rritje të qëndrueshmërisë, KEP Trust po synon të integrojë në mënyrë progresive parimet MSQ në kornizat e raportimit të tij. Kjo përfshin krijimin e një procesi të standardizuar të mbledhjes së të dhënave MSQ në të gjitha departamentet, për të mundësuar raportim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Duke përmirësuar si procedurat e auditimit të brendshëm, edhe kornizën ligjore të pajtueshmërisë, KEP Trust dëshmon gatishmërinë e tij për të përmbushur detyrimet e raportimit, sidomos në çështjet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë. Më konkretisht, KEP Trust po përgatitet të zbatojë auditime me fokus në MSQ në kuadër të sistemit të auditimit të brendshëm në vitet e ardhshme, të cilat do të vlerësojnë pajtueshmërinë me praktikën e qëndrueshmërisë, veçanërisht në aktivitetet operacionale dhe të kredidhënies. Ndërkohë që huadhënësit ndërkombëtarë po i japin gjithnjë e më shumë përparësi kritereve MSQ, qasja strategjike e KEP Trust është e pozicionuar mirë për të mundësuar sukses të qëndrueshëm dhe rritje të përgjegjshme.

3.3. Qasje ndaj menaxhimit të rrezikut

KEP Trust i kushton rëndësi të madhe menaxhimit të rrezikut, i cili është një element thelbësor për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe suksesit afatgjatë të organizatës. Kjo qasje nuk përqendrohet vetëm në identifikimin e rreziqeve të mundshme, por edhe në menaxhimin dhe zbutjen e tyre për të mbrojtur operacionet e institucionit. Përmes përkushtimit ndaj praktikave më të mira dhe strategjive në zhvillim, KEP Trust kultivon një kulturë të vetëdijshme ndaj rrezikut, e cila është në përputhje me vlerat e saj thelbësore dhe promovon praktika financiare të përgjegjshme.

Korniza e menaxhimit të rrezikut e KEP Trust bazohet në një proces të strukturuar që përfshin identifikimin, matjen, menaxhimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të rrezikut. Për më tepër, KEP Trust garanton zbatimin e politikave të qarta (Politika e Rrezikut Kreditor, Politika e Rrezikut të Likuiditetit, Politika e Menaxhimit të Rrezikut dhe Politika e Rrezikut Operacional) në të gjitha nivelet organizative. Bashkëpunimi me Bordin Menaxhues siguron që ekspozimi ndaj rrezikut t'i nënshtrohet vlerësimit të vazhdueshëm dhe të mbahet brenda kufijve të pranueshëm, duke mundësuar marrjen e vendimeve mbi bazën e informacionit si dhe planifikim afatgjatë. Fushat kryesore të menaxhimit të rrezikut përfshijnë rrezikun kreditor, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit, rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun e financimit, si dhe rrezikun mjedisor e social.

Rreziku kreditor, një nga rreziqet më të rëndësishme me të cilat përballet KEP Trust, zbutet përmes një vlerësimi gjithëpërfshirës të kapacitetit të kredimarrësit për shlyerjen e kredisë dhe monitorimit aktiv të performancës së kredisë. Duke kultivuar marrëdhënie të qëndrueshme me klientët dhe duke mbajtur një portofol të kredive me cilësi të lartë, institucioni zvogëlon probabilitetin e mospagesës. Për më tepër, provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë garantojnë që KEP Trust të jetë i përgatitur në mënyrë të duhur për t'u përballur me çfarëdo pasoje financiare që mund të rezultojë nga kreditë joperformuese.

Rreziku operacional adresohet përmes pjesëmarrjes aktive të punonjësve, të cilët inkurajohen të marrin pjesë në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve. Kjo qasje bashkëpunuese forcohet nga përdorimi i Treguesve Kyç të Rrezikut (TKRr), të cilët shërbejnë si sinjale të paralajmërimit të hershëm për çdo çështje në zhvillim. Krijimi i platformave digjitale bashkëkohore dhe lehtësisht të përdorshme nga përdoruesit mundëson një mjedis pune transparent, ku personeli mund të mbikëqyrë në mënyrë efikase proceset operationale, duke forcuar strategjitë e zbutjes së rrezikut.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit përqendrohet në sigurimin e rrjedhës së mjaftueshme të parasë së gatshme për të përmbushur detyrimet aktuale dhe të ardhshme. Portofoli i KEP Trust, i cili përbëhet nga shumë kredi të vogla me afate

të parashikueshme të pagesës, përmirëson saktësinë e parashikimit dhe ofron stabilitet të rrjedhës së parasë së gatshme. Testimet e rregullta të stresit të likuiditetit kryhen për të vlerësuar dobësitë e mundshme dhe për t'i ndihmuar institucionit të ruajë një pozicion të fortë të likuiditetit, edhe gjatë periudhave me tronditje të jashtme.

Edhe pse rreziku nga valuta e huaj konsiderohet e papërfillshme, pasi aktivet dhe detyrimet shprehen në EUR, rreziqet nga norma e interesit dhe financimi menaxhohen në mënyrë aktive. KEP Trust mban raporte të ulëta të leverazhit përmes shfrytëzimit të një baze të fortë kapitali, e cila shërben për të siguruar rezultate financiare të parashikueshme. Analizat e hendekut të maturimit kryhen gjithashtu për të harmonizuar maturitetet e aktiveve me ato të detyrimeve, duke minimizuar rrezikun e efekteve negative në fitim për shkak të mospërputhjeve të normave të interesit.

Që nga viti 2021, KEP Trust ka operuar me SMSM për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet M&S të ndërlidhura me aktivitetet e kredidhënies, duke siguruar kështu që të gjitha vendimet financiare të pasqyrojnë përkushtimin e organizatës ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo qasje e strukturuar i mundëson KEP Trust të rishikojë dhe klasifikojë në mënyrë të detajuar aktivitetet e kredidhënies bazuar në ndikimin e tyre të mundshëm M&S, duke harmonizuar kështu aktivitetet financiare më nga afër me synimet e qëndrueshmërisë. Informata të detajuara janë ofruar në Seksionet 2.1 dhe 5.2. Si pjesë e përpjekjeve për përmirësim të vazhdueshëm, KEP Trust thekson rëndësinë e kontrolleve të brendshme të fuqishme dhe zhvillimit profesional. Për më tepër, KEP Trust ndan mjete për zbatimin e programeve të specializuara të trajnimit për punonjësit e saj, duke mundësuar kështu përmirësimin e aftësive të tyre në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve. Gjatë tri viteve të fundit, trajnimi është përqendruar në fusha kritike si menaxhimi i rrezikut, duke fuqizuar më tej stafin për të kontribuar në një mjedis operacional të sigurt dhe efikas.



4. Përgjegjësia sociale

4.1. Vlera për shoqërinë

KEP Trust synon të krijojë vlerë të konsiderueshme për shoqërinë duke nxitur rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe mirëqenien e komuniteteve në Kosovë. Përkushtimi i KEP Trust shkon përtej performancës financiare, në adresimin aktiv të sfidave shoqërore dhe mjedisore. KEP Trust synon të nxisë ndikime pozitive sociale përmes praktikave të përgjegjshme të kredidhënies, mbështetjes së bizneseve dhe ndërmarrësve lokalë, si dhe investimit në nisma që promovojnë edukimin, shëndetin dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Ky theks përputhet me gjetjet e analizës sonë të materialitetit, ku Ndikimi Pozitiv Social doli si një nga prioritetet kryesore si për palët e brendshme të interesit, ashtu edhe për ato të jashtme. Duke i dhënë prioritet praktikave etike, gjithëpërfshirjes dhe angazhimit komunitar, KEP Trust synon të përmirësojë cilësinë e jetës për Kosovarët, të kontribuojë në synimet e zhvillimit të vendit dhe të sigurojë që rritja e organizatës të jetë në harmoni me interesat më të gjera të shoqërisë.

4.1.1. Produktet dhe shërbimet

Institucionet mikrofinanciare luajnë rol kyç në përmirësimin e qasjes në shërbimet financiare për individët me të ardhura të ulëta dhe për bizneset e vogla, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik. KEP Trust, në përputhje me misionin e saj, zgjeron mundësitë ekonomike brenda komunitetit duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare të dizajnuara për të promovuar përfshirjen financiare.

Ofertat e KEP Trust përfshijnë një gamë të larmishme kredish si kredi për bujqësi, kredi biznesi, kredi për banim, kredi super ekspres, të gjitha të përshtatura për të përmbushur nevojat e atyre që shpesh përjashtohen nga sistemet bankare tradicionale. Këto kredi fuqizojnë ndërmarrësit ose individët që të realizojnë aspiratat e tyre dhe të nxisin rritjen, duke e përmirësuar sigurinë e tyre financiare. Përmes këtyre produkteve dhe shërbimeve financiare, KEP Trust jo vetëm që e mbështet fuqizimin financiar individual, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin ekonomik më të gjerë të komuniteteve, duke punuar drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

KEP Trust është i përkushtuar të sigurojë që të gjitha kërkesat vlerësohen në mënyrë të paanshme bazuar në meritat e tyre dhe në kriteret e vendosura. Pas miratimit të një kredie, klientët informohen plotësisht për kushtet e kredisë. KEP Trust gjithashtu i mbështet këta klientë në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

KEP Trust është i përkushtuar të sigurojë që të gjitha kërkesat vlerësohen në mënyrë të paanshme, bazuar në meritat e tyre dhe në përmbushjen e kriterëve. Pas miratimit të një kredie, KEP Trust garanton që klientët janë të informuar plotësisht për kushtet e kredisë. Përveç kësaj, KEP Trust gjithmonë i mbështet klientë e vetë duke i ndihmuar të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm.

Llojet e kredive

- Kredi biznesi

Kredi biznesi, e ofruar nga KEP Trust është në dispozicion për shuma deri në 25,000 EUR dhe mund të përdoret për një sërë qëllimesh, duke përfshirë investimin në infrastrukturë, renovimin e objekteve, blerjen e pajisjeve ose teknologjisë së re, rritjen e kapitalit punues dhe investime të tjera themelore për biznese. Kjo kredi ofron disa përparësi si norma e favorshme e interesit, asnjë tarifë administrative tjetër dhe miratimi i kredisë brenda 24 orëve. Për më tepër, klientët mund të marrin kredi deri në 15,000 EUR pa pasur nevojë për hipotekë, me kushte pagese fleksibile deri në 60 muaj.

- Ekspres Kredi Biznesi

Kushtet për ekspres kredi biznesi përfshijnë shuma të kredive nga 200 EUR deri në 3,000 EUR, me periudha kthimi deri në 36 muaj. Këto kredi nuk kërkojnë kolateral ose garantues dhe ofrohen pa tarifa administrative.

- Kredi për Bujqësi

Kreditë për Bujqësi nga KEP Trust janë në dispozicion për shuma deri në 25,000 EUR dhe mund të përdoren për qëllime të ndryshme, përfshirë rritjen e kapacitetit prodhues, zgjerimin e fermave, rritjen e numrit të bagëtive, blerjen e pajisjeve dhe makinerive bujqësore, si dhe përgatitjen për kushtet stinore. Përparësitë kryesore të këtyre kredive përfshijnë një plan pagese fleksibil, norma të favorshme interesi, asnjë tarifë administrative, ku kredia lëshohet brenda 24 orëve. Për më tepër, klientët mund të marrin kredi deri në 5,000 EUR pa pasur nevojë për garantues apo kolateral, së bashku me një grejs-periudhë deri në gjashtë muaj dhe afat kthimi deri në 60 muaj.

- Super Ekspres Kredi

Me Super Ekspres Kredi, që aplikohet për të gjitha produktet, KEP Trust ofron kredi deri në 3,000 EUR me kushte të favorshme, me afat kthimi deri në 36 muaj dhe zero kosto administrative. Për ata që kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe të drejtpërdrejta, Super Ekspres Kredia paraqet një mundësi ideale.

- Kredi për Banim

Kushtet për Kreditë për Banim përfshijnë shuma nga 3,000 EUR deri në 25,000 EUR, me afat kthimi deri në 60 muaj. Kjo kredi ka norma të favorshme interesi, pa

tarifa administrative. Miratimi jepet brenda 24 orëve, dhe kreditë deri në 5,000 EUR nuk kërkojnë garantues ose kolateral.

- Ekspres kredi konsumuese

Për klientët që kanë nevojë të blejnë pajisje shtëpiake, të regjistrojnë një automjet ose të mbulojnë ndonjë shpenzim personal të menjëhershëm, KEP Trust ofron zgjidhje përmes Ekspres kredisë konsumuese. Kushtet përfshijnë shumën nga 200 EUR deri në 2,000 EUR, me afat kthimi deri në 36 muaj. Këto kredi nuk kërkojnë kolateral ose garantues dhe ofrohen pa tarifa administrative.

- Ekspres Kredi për Përmirësimin e Kushteve të Banimit

Kushtet për Ekspres Kredi për Përmirësimin e Kushteve të Banimit përfshijnë shumën nga 200 EUR deri në 3,000 EUR, me periudha kthimi deri në 36 muaj. Këto kredi nuk kërkojnë kolateral ose garantues dhe ofrohen pa tarifa administrative.

Gama e larmishme e kredive të KEP Trust fuqizon individët dhe komunitetet, duke mbështetur si rritjen financiare personale, ashtu edhe zhvillimin ekonomik më të gjerë. Tabela më poshtë paraqet investimet e bëra nga viti 2021 deri në 2023 në fusha të ndryshme, duke përfshirë mbështetjen për gratë ndërmarrëse, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), dhe ndërmarrësit individualë. Në mënyrë të veçantë, përkushtimi ynë ndaj qëndrueshmërisë është i dukshëm përmes “kredive të gjelbra”, të cilat financojnë projekte të përgjegjshme ndaj mjedisit, si përmirësimi i efikasitetit energjetik, praktikat e qëndrueshme bujqësore dhe iniciativa për energji të ripërtërishme.

Përmes këtyre investimeve, KEP Trust jo vetëm që e përmirëson përfshirjen financiare, por gjithashtu forcon përgjegjësinë sociale dhe mjedisore, duke harmonizuar produktet tona financiare me një vizion për një të ardhme më të qëndrueshme.

Tabela në vijim paraqet llojet e kredive në të cilat ka investuar KEP Trust, si dhe shumën në EUR të investimeve të tyre.

Tema	Investim në Projekte (EUR)		
	2021	2022	2023
Ndërmarrëse Gra/Fuqizim i Grave	1,780,303	2,509,733	3,632,979
NVM	1,629,051	4,791,396	7,757,388
Ndërmarrës	11,198,429	13,970,998	18,645,890
Kredi të gjelbra	1,585,405	1,745,669	4,354,179
Të tjera	9,036,972	12,435,359	17,685,098

4.1.2. Përfshirja financiare

Siç përcaktohet në misionin e KEP Trust, si një institucion mikrofinanciar, përfshirja financiare është një nga vlerat më kryesore për organizatën. Ajo mbështet individët me të ardhura të ulëta dhe bizneset e vogla që të kenë qasje në mundësi ekonomike, duke iu ofruar shërbime financiare. Prandaj, KEP Trust promovon zhvillimin e qëndrueshëm dhe nxit një shkallë më të gjerë të mirëqenies brenda komuniteteve. Falë kësaj qasjeje, KEP Trust synon të fuqizojë komunitetet dhe të përmirësojë pavarësinë e tyre ekonomike.

Zhvillimi i përmbajtjes edukative për të përmirësuar njohuritë financiare si për klientët ekzistues edhe për ata potencialë, është me rëndësi thelbësore. Kjo përmbajtje përfshin artikuj informues, video, seminare në internet, punëtori dhe trajnime. Duke organizuar aktivitete edukative dhe duke ofruar përmbajtje, KEP Trust synon t'u ndihmojë klientëve të kuptojnë më mirë produktet dhe shërbimet financiare. Kjo perspektivë u mundëson klientëve të marrin vendime të bazuara në informacion lidhur me nevojat dhe përgjegjësitë e tyre financiare, duke promovuar kështu përfshirje financiare të përgjegjshme.

4.1.3. Mbrojtja e klientëve

Mbrojtja e klientëve është një ndër aspektet më themelore për KEP Trust. Si një institucion mikrofinanciar, KEP Trust zbaton një qasje shumë të ndjeshme për të vënë në plan të parë nevojat e klientëve dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Në këtë drejtim, sigurimi që shërbimet financiare të ofruara nga Organizata të jenë të drejta, transparente dhe të besueshme është i vlefshëm dhe i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Parimet e mbrojtjes së klientëve jo vetëm që janë pjesë përbërëse e kulturës organizative, por gjithashtu pasqyrojnë përkushtimin e saj për të mbështetur pavarësinë ekonomike të klientëve.

Si dëshmi e përkushtimit të KEP Trust ndaj mbrojtjes së klientëve dhe praktikave të qëndrueshme, organizata ka marrë mirënjohje për përpjekjet e veta në sektorin mikrofinanciar. Përkushtimi i saj për ofrim të shërbimeve etike dhe fuqizim të klientëve ka rezultuar me disa çmime prestigjioze.

KEP Trust ka marrë Certifikatën për Mbrojtjen e Klientëve nga "MFR Certification", duke arritur nivelin e artë në mbrojtjen e klientëve. Niveli i artë përfaqëson standardin më të lartë të arritjes dhe tregon që KEP Trust i respekton kriteret më të rrepta për mbrojtjen e klientëve, siç janë përcaktuar në Standardet Universale për Menaxhimin e Performancës Sociale dhe Mjedisore.

Këto certifikime vënë në pah përkushtimin e KEP Trust për të respektuar parimet dhe praktikën që sigurojnë mbrojtjen dhe trajtimin e drejtë të klientëve të saj. Mirënjohja që KEP Trust ka marrë shërben jo vetëm si validim i qasjes së saj, por edhe si motivim për të vazhduar përpjekjet drejt përsosmërisë në të gjitha aspektet e operacioneve të saj.

4.1.4. Qasja ndaj përgjegjësisë sociale korporative

KEP Trust është i përkushtuar të mbështesë nisma që kontribuojnë në mirëqenien dhe zhvillimin e komunitetit në Kosovë, përfshirë trashëgiminë kulturore, shëndetin, sportin dhe qëndrueshmërinë mjedisore.

Në fushën e kulturës, KEP Trust mbështet festivale dhe nisma të shumta që kanë për qëllim promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë së pasur kulturore të Kosovës. Këto aktivitete jo vetëm që ruajnë traditat dhe historinë, por gjithashtu forcojnë lidhjet midis komuniteteve kulturore. Duke mbështetur këto nisma, KEP Trust luan një rol jetik në sigurimin që trashëgimia kulturore të vlerësohet dhe t'u përcillet gjeneratave të ardhshme. Me fjalë të tjera, KEP Trust kultivon një kulturë që vlerëson shërbimin komunitar dhe përgjegjësinë sociale, duke e bërë normë që punonjësit të angazhohen në aktivitete të tilla. Duke i motivuar punonjësit të marrin pjesë në këto aktivitete dhe nisma që janë në përputhje me objektivat strategjike të kompanisë, siç janë qëndrueshmëria dhe edukimi financiar, KEP Trust forcon përkushtimin e tij ndaj suksesit afatgjatë dhe ndikimit pozitiv shoqëror.

KEP Trust vazhdon të rrisë dukshmërinë e markës dhe përgjegjësinë korporative duke u angazhuar në sponsorizime dhe duke dhënë donacione. Organizata do të përqendrohet në mbështetjen e federatave sportive dhe ngjarjeve kulturore me shtrirje kombëtare, me theks të veçantë në promovimin e avancimit të grave, personave me nevoja të veçanta dhe grupeve të tjera të cenueshme.

KEP Trust ka ofruar donacione për të mbështetur kauzat në lidhje me shëndetin, sidomos për individët që kanë nevojë për trajtim mjekësor jashtë vendit. Këto përpjekje bamirësie pasqyrojnë përkushtimin e Organizatës ndaj përgjegjësisë sociale si dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për përmirësimin e mirëqenies komunitare.

4.1. Bashkëpunimet, donacionet dhe sponsorizimet

KEP Trust angazhohet në mënyrë aktive në bashkëpunime, duke dhënë donacione dhe sponsorizime për të forcuar përkushtimin e saj ndaj mirëqenies së komunitetit dhe përgjegjësisë sociale. KEP Trust bashkëpunon me organizata dhe nisma të ndryshme, duke u përqendruar në projekte me ndikim që përputhen me vlerat e saj. Për shembull:

- Në fushën e arsimit, ndër të tjera, KEP Trust kontribuon duke sponsorizuar “Ligën e Krijuesve Kosovarë” në blerjen e robotëve për nxënësit e shkollave publike në Kosovë, të cilët më pas marrin pjesë në garën shtetërore të robotikës. Po ashtu, ne kemi sponsorizuar “Institutin ATOMI”, i cili ka për qëllim identifikimin dhe mbështetjen e individëve të talentuar me inteligjencë të jashtëzakonshme.
- Për sa i përket ndihmës në edukimin profesional dhe atë financiar, KEP ka themeluar Fondacionin për Zhvillimin e Bujqësisë “Agrodev” me qëllim rritjen e sektorit të bujqësisë në Kosovë përmes informimit, zhvillimit dhe promovimit.
- KEP Trust gjithashtu ofron ndihmë financiare për dhjetëra raste që kërkojnë trajtim mjekësor jashtë vendit, duke dëshmuar përkushtimin tonë ndaj shëndetit dhe mirëqenies së bashkëqytetarëve tanë. KEP Trust bashkëpunon gjithashtu me organizata të ndryshme që fokusohen në nisma të përgjithshme shëndetësore dhe aktivitete të shëndetit mendor anembanë Kosovës. Duke kontribuar në këto programe shëndetësore jetike, organizata synon të përmirësojë cilësinë e jetës për individët dhe familjet në nevojë.
- Në fushën e sportit, KEP Trust luan një rol të spikatur si një nga sponsorët kryesorë të Federatës së Hendbollit të Kosovës. Mbështetja e Organizatës shtrihet përtej hendbollit, pasi ajo sponsorizon gjithashtu aktivitete në futboll, basketboll dhe tenis, me theks të veçantë në faktin që është sponsori kryesor i Federatës së Tenisit të Kosovës.

Përmes këtyre sponsorizimeve, KEP Trust synon të promovojë aktivitetin fizik, punën në ekip dhe ndjekjen e përsosmërisë në mesin e sportistëve të të gjitha moshave. Për më tepër, duke njohur rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, KEP Trust financon organizata të përkushtuara ndaj mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit natyror. Në këtë drejtim, Organizata gjithashtu kontribuon në krijimin e materialeve dhe nismave edukative që rrisin ndërgjegjësimin për çështjet mjedisore dhe inkurajojnë praktikën e qëndrueshme.

Në vitin 2023, investimi i KEP Trust në projekte të komunitetit dhe përgjegjësisë sociale korporative është më i madh se shuma e investimeve të bëra në vitet 2021 dhe 2022.

	2021	2022	2023
Buxheti i shpenzuar në investimet në komunitet dhe në Projekte të PSK (EUR)	89,593	81,382	199,292

Kjo shumë e investimeve korrespondon me 5.25% të tepricës neto të institucionit për vitin 2023.

4.2. Vlera për punonjësit

Në KEP Trust, punonjësit vlerësohen jashtëzakonisht shumë dhe konsiderohen shtylla kryesore e suksesit të organizatës. KEP Trust është i përkushtuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe pasurues të punës, që i jep përparësi zhvillimit profesional dhe personal, një përkushtim ky që përputhet ngushtë me gjetjet e analizës sonë të materialitetit, ku mirëqenia e punonjësve, mjedisi i shëndetshëm i punës dhe zhvillimi i punonjësve dolën si prioritetet kryesore si për palët e brendshme të interesit, ashtu edhe për ato të jashtme.

Pako gjithëpërfshirëse e përfitimeve e KEP Trust është dizajnuar me qëllim që të mbështesë si mirëqenien profesionale, ashtu edhe atë personale. KEP Trust ofron sigurim shëndetësor, jetësor dhe të aftësive të kufizuara, për të siguruar rehatinë dhe lumturinë e punonjësve. Ata mund të përfitojnë gjithashtu nga bonuset e performancës dhe bonuset e fundvitit që shpërblejnë punën e tyre të palodhur. KEP Trust është i përkushtuar ndaj zhvillimit të vazhdueshëm, duke ofruar mundësi për rritje profesionale dhe pushime personale për provime universitare. Fleksibiliteti në punë përfshin opsionin e punës nga shtëpia dhe orar të përshtatur të punës, për t'iu përshtatur stilit të jetesës së punonjësve. Përfitimet shtesë përfshijnë kompensimin për shpenzimet e makinës, mbulimin e shpenzimeve të telefonit dhe mundësinë e marrjes së një page paraprakisht me këste deri në 12 muaj. KEP Trust ofron gjithashtu pushim shtesë për nënat me fëmijë deri në moshën tre vjeç, për prindërit vetushqyes, si dhe mbështetje financiare në rast sëmundjeje ose për kujdesin për të afërm të sëmurë, duke siguruar që punonjësit të kenë mbështetjen e nevojshme në të gjitha aspektet e jetës së tyre.

4.2.1. Profili i Punonjësit

Në KEP Trust, profili i punonjësve pasqyron një fuqi punëtore të larmishme dhe gjithëpërfshirëse, e përkushtuar në nxitjen e një mjedisi pune bashkëpunues dhe mbështetës. Sipas të dhënave më të fundit, KEP Trust ka gjithsej 248 punonjës, me një shpërndarje gjinore që shfaq ekuilibër të dukshëm mes burrave dhe grave. Fuqia punëtore e KEP Trust përfshin moshë të ndryshme, ku 15% e punonjësve janë nën 30 vjeç, 70% e tyre janë midis 30 dhe 50 vjeç, dhe 15% mbi 50 vjeç. Organizata ofron lloje të ndryshme të marrëveshjeve të punës, ku mbizotërojnë pozitat me orar të plotë.

KEP Trust është gjithashtu i përkushtuar ndaj gjithëpërfshirjes, duke punësuar gjithsej 4 persona me aftësi të kufizuara, pa dallim gjinie. Praktikrat e rekrutimit të

KEP Trust tregojnë një rrjedhë dinamike të talenteve të reja, ku viteve të fundit shihet një përzjerje e punësimeve si të burrave edhe të grave. Punonjëset që shkojnë në pushimin e lehonisë ose që marrin pushimin prindëror janë të mbështetura mirë, ku shkalla e kthimit është shumë e lartë prej 91-100% pas përfundimit të periudhës së pushimit. Shkalla e largimit nga puna në KEP Trust varion dhe të dhënat më të fundit të kësaj shkalle janë 7.96%. Këto të dhëna theksojnë përkushtimin e KEP Trust ndaj ruajtjes së një mjedisi pune mbështetës dhe të larmishëm.

TKP-të përkatës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke nxjerrë në pah metrikat dhe treguesit kyç të performancës që ndërlidhen me profilin e punonjësve të KEP Trust gjatë tri viteve të fundit.

TKP	2021				2022				2023			
	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE
Numri i përgjithshëm i punonjësve	128		113		127		118		127		121	
	241				245				248			
Organet drejtuese dhe numri i personave në Bordin e Drejtorëve	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	3		2		3		2		2		3	
	5				5				5			
Numri i punonjësve duke përfshirë organet menaxhuese	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE
	125		112		124		117		124		120	
237				241				244				
Numri i punonjësve nën moshën 30 vjeç	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE	FTE	PTE
	13		26		10		29		12		26	
39				39				38				
Numri i punonjësve të moshës 30-50	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	96		77		96		74		92		81	
	173				170				173			
Numri i punonjësve mbi moshën 50 vjeç	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	19		10		21		15		23		15	
	29				36				38			
Numri i punonjësve sipas orarit të punës	FTE		PTE		FTE		PTE		FTE		PTE	
	236		9		243		4		246		4	
Numri i punonjësve me aftësi të kufizuara	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	1		3		1		3		1		3	
	4				4				4			
Numri i punonjësve të sapo-rekrutuar	Mashkull		Femër		Mashkull		Femër		Mashkull		Femër	
	8		11		7		7		8		15	
	19				14				23			
Numri i punonjësve gra në pushim të lehonisë/pushim prindëror	10				11				12			
Numri i punonjësve gra që kthehen në punë pas përfundimit të pushimit të lehonisë/pushimit prindëror	10				11				11			
Proporcioni i punonjësve gra që kthehen në punë pas përfundimit të pushimit të lehonisë/pushimit prindëror (%)	100%				100%				91%			
Shkalla e largimit të punonjësve (%)	11.97%				4.89%				7.96%			

4.2.2. Qasja ndaj burimeve njerëzore

KEP Trust është i përkushtuar të nderojë shumëllojshmërinë dhe të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë. Praktikën e rekrutimit të organizatës përqendrohen ekskluzivisht në aftësitë dhe kualifikimet e individit, pa marrë parasysh aspektet personale si prejardhja, mosha, gjinia, raca, aftësia e kufizuar apo feja.

Për më tepër, KEP Trust zbaton politikën me tolerancë zero ndaj diskriminimit, ngacmimit ose sjelljes abuzive. Kjo vlen për të gjithë punonjësit, klientët, furnitorët, kontraktorët dhe cilindo individ tjetër që angazhohet nga institucioni. Sjellja e papranueshme përfshin kërcënimet, kontaktin fizik, komentet nënçmuese, talljet ose çdo veprim tjetër fytes apo abuziv që cenon dinjitetin e një personi, krijon mjedis fytes ose bën që një individ të mos ndihet rehat, të ndihet i kërcënuar, i ofenduar ose i shqetësuar.

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara bëhet në përputhje me Politikën e Burimeve Njerëzore dhe legjislacionin aktual, që parasheh që: “Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor. Punëdhënësit që nuk e përmbushin këtë obligim duhet të paguajnë një tarifë mujore të barabartë me pagën minimale në fuqi në Republikën e Kosovës për çdo person me aftësi të kufizuara, me qëllim të nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”.

KEP Trust i respekton praktikën e drejtë të punës, përfshirë ndalimin e punës së fëmijëve, punës së detyruar dhe sigurimin e kushteve të sigurt dhe të shëndetshme të punës. Punonjësit kanë të drejtën e asociimit të lirë dhe negociatave kolektive.

KEP ofron mekanizma efektive për ankesa për punonjësit, palët e interesit dhe komunitetet e prekura, për të paraqitur shqetësimet lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut në KEP Trust

Qasja e një organizate ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut përfshin një strategji gjithëpërfshirëse dhe proaktive që integron të drejtat e njeriut në të gjitha aspektet e operacioneve të saj, nga politikën e brendshme të partneritetit të jashtëm, duke siguruar që organizata të kontribuojë pozitivisht në mirëqenien dhe dinjitetin e individëve dhe komuniteteve.

KEP Trust është transparent në lidhje me praktikën dhe ndikimet e saj në të drejtat e njeriut, duke siguruar pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret kombëtare për të drejtat e njeriut. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut në KEP Trust janë pjesë e grupit të Politikave të Burimeve Njerëzore të miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Bërja e biznesit me transparencë dhe trajtimi i klientëve dhe stafit me dinjitet janë pjesë përbërëse e kulturës institucionale të KEP Trust.

4.2.2.1. Menaxhimi i performancës, zhvillimi i kapaciteteve dhe trajnimet

Zhvillimi i punonjësve është me rëndësi kritike për qëndrueshmërinë e operacioneve të KEP Trust dhe ofrimin efektiv të shërbimeve. Avancimi i kompetencave të stafit jo vetëm që përmirëson performancën e përgjithshme të KEP Trust, por edhe rrit cilësinë e shërbimeve që organizata ofron. Prandaj, KEP Trust i kushton rëndësi të madhe zhvillimit të kapaciteteve, duke synuar të forcojë aftësitë profesionale të anëtarëve të ekipit dhe të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për rritjen e tyre.

Vlerësimi i performancës së punonjësve bëhet të paktën një herë në vit. KEP Trust i konsideron këto vlerësime si një mënyrë pozitive për të përmirësuar efikasitetin individual në punë, si dhe për të ndihmuar zhvillimin profesional të të gjithë punonjësve në Institucion. Kjo arrihet përmes vlerësimit të performancës për të gjithë punonjësit përmes përdorimit të formularëve të vlerësimit. Performanca e punonjësit vlerësohet gjithashtu kur ai/ajo përfundon periudhën provuese, transferohet ose gradohet, ose kalon në një pozitë tjetër. Departamenti i Burimeve Njerëzore i informon të gjithë punonjësit për procesin e vlerësimit të performancës dhe u dërgon mbikëqyrësve formularët përkatës. Po ashtu, Departamenti i Burimeve Njerëzore i shpallë afatet kohore për këtë proces.

Vlerësimi i performancës duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për punonjësit. Ky proces gjithashtu duhet të ofrojë informata kthyesë të mira për ndërtimin e planeve të zhvillimit profesional dhe/ose trajnimeve për punonjësit, duke u përqendruar në objektiva specifike, orientim në karrierë dhe ndryshime në sistemet e motivimit.

Trajnimet luajnë një rol thelbësor në arritjen e objektivave strategjike të KEP Trust. Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve të tij është thelbësor si për suksesin individual ashtu edhe për atë organizativ. Në KEP Trust, procesi i trajnimit shihet si një përpjekje e vazhdueshme dhe dinamike, e jo si ngjarje e

njëhershme. Me këtë perspektivë, KEP Trust dëshmon qartë përkushtimin ndaj zhvillimit të strukturuar dhe sistematik të punonjësve të tij, pavarësisht nivelit aktual të aftësive ose pozicionit të tyre brenda organizatës. Ky përkushtim siguron që të gjithë anëtarët e ekipit të kenë qasje në programe të personalizuar trajnimi dhe në burime që nxisin përmirësim të vazhdueshëm dhe rritje profesionale.

Duke zbatuar një qasje proaktive, KEP Trust mbështet punonjësit që të përshtaten me kushtet e ndryshueshme të tregut dhe që të ofrojnë shërbime

mecilësi të lartë. Duke vepruar në këtë mënyrë, organizata jo vetëm që kontribuon në lrritjen e tyre personale, por gjithashtu forcon përkushtimin ndaj komuniteteve që i shërben.

Në vitin 2023, KEP Trust investoi gjithsej 40,000 EUR në trajnim të punonjësve, duke theksuar një varg fushash thelbësore për të mbështetur rritjen profesionale dhe përsosmërinë operacionale. Programet e trajnimit u përqendruan në certifikim, digjitalizim dhe aftësi të buta, duke trajtuar tema të rëndësishme si Menaxhimi i Rrezikut, Auditor i Certifikuar, Auditor i TI, Analitika e të Dhënave dhe metodat “Agile-Scrum”. Fusha të tjera kyçe përfshinë Sigurinë e Informacionit/Sigurinë Kibernetike, Mbrojtjen e Të Dhënave (GDPR), Menaxhimin e Projekteve, “Power BI”, kreditë “GEFF” dhe Pasqyrat Financiare. KEP Trust i jep gjithashtu përparësi Shërbimit ndaj Klientit, Marketingut Digjital, Kujdesit të Duhur ndaj Klientit (KDK) dhe Njih Klientin Tënd (NJKT). Këto nisma të larmishme trajnimi janë krijuar për të rritur angazhimin e punonjësve dhe për të siguruar që ekipi të jetë i pajisur mirë për të lundruar në peizazhin financiar evolues, dhe njëkohësisht për të nxitur zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

Tabela më poshtë tregon të dhënat përkatëse të trajnimeve të ofruara nga KEP Trust gjatë tri viteve të fundit.

Trajnimet	2021	2022	2023
Numri i përgjithshëm i personave të trajnuar	45	251	180
Gjithsej trajnime (orë)	2,132	4,593	3,621
Gjithsej trajnime (person x orë)	47	18	20

4.3. Digjitalizimi

Në botën financiare që sot po ndryshon me shpejtësi, digjitalizimi po e riformëson industrinë e IMF-ve, duke e ndryshuar mënyrën se si institucionet funksionojnë dhe lidhen me klientët. IMF-të po i përqafojnë teknologjitë e avancuara me qëllim të përmirësimit të efikasitetit operacional, uljes së kostove dhe ofrimit të përvoja të personalizuar dhe të vazhdueshme për klientët. Këto inovacione u mundësojnë institucioneve financiare të ofrojnë zgjidhje në kohë reale, të përshtatura sipas nevojave, të nxisin angazhim dhe qasje më të madhe, dhe të eliminojnë gabimet njerëzore gjatë përpunimit të të dhënave. Për këtë arsye, KEP Trust i jep përparësi digjitalizimit dhe inovacionit, si dhe ka themeluar Komitetin Drejtues të Digjitalizimit për të vlerësuar dhe zbatuar veprimet operacionale.

Si pjesë e përkushtimit të saj të vazhdueshëm ndaj qëndrueshmërisë, KEP Trust ka bërë përparim të madh në lehtësimin e procedurave të kredidhënies dhe është

bërë më pak i varur nga teknikat tradicionale të bazuara në letër, duke përdorur platforma globale si “DocuSign” dhe duke përfshirë zgjidhje elektronike. Organizata ka arritur të zvogëlojë dokumentacionin e panevojshëm dhe të thjeshtojë proceset falë këtij ndryshimi. Një arritje e rëndësishme në qasjen e transformimit digjital është zvogëlimi domethënës i dokumenteve të shtypura në lidhje me administrimin e kredive. KEP Trust ka arritur të ulë konsumimin e letrës për 25% vitin e kaluar, duke ndihmuar kështu në kursimin e parave dhe në mbrojtjen e mjedisit. Për më tepër, plani i trajnimit i Organizatës këtë vit përqendrohet në digjitalizim, duke pajisur punonjësit me aftësitë e nevojshme për të naviguar dhe kontribuar në peizazhin digjital që po evoluon. Përveç trajnimeve tradicionale, këto programe synojnë të ofrojnë certifikime që rrisin si kualifikimet individuale, ashtu edhe kapacitetin e përgjithshëm organizativ. Gjithashtu, KEP Trust ka një platformë për mësim elektronik, ku trajnimet mund të përfundohen përmes interneti në çdo kohë dhe nga kudo. TKP-të e KEP Trust për vitet e fundit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

TKP-të	2021	2022	2023
Numri i klientëve të përfituar në mënyrë digjitale	1,249	1,178	1,839
Numri i klientëve që kanë aplikacionin për shërbime bankare mobile	N/A	N/A	N/A
Pjesëmarrja e kanaleve digjitale në shitje (%)	5.28	4.52	5.98
Kursimi i letrës përmes digjitalizimit (ton)	10.15	12	8.59

5. Përgjegjësia mjedisore

KEP Trust e kupton rolin e saj vendimtar në mbështetjen e një të ardhmeje të qëndrueshme duke i dhënë përparësi përgjegjësisë mjedisore. Përdorimi i ndikimit të tij pozitiv në uljen e gjurmëve mjedisore në institucionet financiare përmes klientëve dhe punonjësve mund të jetë i dobishëm përmes inkurajimit të praktikave të qëndrueshme. Në këtë kontekst, KEP Trust është përgjegjës për menaxhimin e ndikimit mjedisor të brendshëm dhe promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore më të gjerë përmes aktiviteteve të saj financiare.

Përgjatë viteve, KEP Trust ka miratuar disa rregullore kyçe në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore për të ofruar vlerësim të besueshëm dhe transparent, ndërsa Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ka hyrë në fuqi në vitin 2009, i pasuar nga Ligji për Menaxhimin e Ujërave në vitin 2013. Ligji për Mbrojtjen e Ajrit dhe Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis u miratuan në vitin 2022 dhe 2023, respektivisht. Në vitin vijues do të miratohet Ligji i ri për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë duke forcuar edhe më tej kornizën rregullative të qëndrueshmërisë.

5.1. Gjurma mjedisore

Ashtu si edhe me të gjitha institucionet financiare, gjurma mjedisore e KEP Trust korrespondon me ndikimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të operacioneve të saj në mjedis, në varësi të prodhimit të mbeturinave, emetimeve të karbonit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore siç janë energjia dhe uji. Edhe pse institucionet financiare në përgjithësi nuk konsiderohen industri me intensitet të lartë të shfrytëzimit të burimeve, operacionet e tyre që lidhen me ndërtesat e zyrave, qendrat e të dhënave dhe logjistikën mund të kontribuojnë ndjeshëm në degradimin mjedisor. Duke filluar përpjekjet e tij drejt qëndrueshmërisë mjedisore që sot, KEP Trust planifikon të forcojë rolin e tij në këshillimin e klientëve se si ta integrojnë qëndrueshmërinë mjedisore në bizneset e tyre, përmes organizimit të trajnimeve, punëtorive dhe nismave të tjera edukative. Në këtë mënyrë, KEP Trust do të ndihmojë klientët e tij për të kuptuar më mirë dhe për t'i zbatuar praktikatat e qëndrueshme.

- KEP Trust tashmë ka organizuar trajnime në bashkëpunim me Departamentin për Bujqësi dhe profesorët e Fakultetit të Bujqësisë, duke ofruar këshilla të vlefshme për fermerët në tema të tilla si mirëqenia e kafshëve dhe prodhimi i qëndrueshëm i kulturave bujqësore. Kjo praktikë kontribuon në sigurimin e asaj që klientët të jenë të pajisur me njohuri dhe burime në fushat bujqësore.
- Si pjesë e qasjes së tij ndaj qëndrueshmërisë, KEP Trust po punon drejt eliminimit të plastikës nga të gjitha zyrat dhe degët e KEP Trust. Kjo praktikë është në përputhje me qëllimin e ardhshëm të Organizatës për të zvogëluar mbetjet dhe për të minimizuar gjurmën mjedisore të vet.
- KEP Trust ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të ripërtërirë flotën e vet të automjeteve me automjete më efikase dhe miqësore me mjedisin, duke ulur nivelin e CO2 në të gjitha departamentet.



- KEP Trust demonstroi praktika të mira duke i regjistruar të dhënat e konsumit në të gjitha lokacionet dhe duke zbatuar projekte me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të energjisë dhe qëndrueshmërisë. Ndikimet kryesore mjedisore të drejtpërdrejta, si shfrytëzimi i burimeve dhe veprimtaritë operacionale, monitorohen nga afër nga Departamenti i Administratës. Organizata monitoron përdorimin e energjisë elektrike, ujit, letrës dhe materialeve të shtypura për të gjitha lokacionet, si dhe konsumimin e derivateve për flotën e saj të automjeteve.
- Në bashkëpunim me administratën e tij, KEP Trust ka zbatuar edhe përmirësime tjera si zëvendësimi i sistemeve të vjetruara të klimatizimit me sisteme moderne shumë efikente në të gjitha degët. Këto përmirësime jo vetëm që e kanë rritur efikasitetin e energjisë, por edhe e kanë forcuar përkushtimin ndaj qëndrueshmërisë në të gjitha operacionet.

Projektet dhe investimet e vazhdueshme të qëndrueshmërisë së KEP Trust përfshijnë kalimin në ndriçim LED, përmirësimin e sistemeve të klimatizimit, aplikimin e izolimit të xhamave dhe zvogëlimin e përdorimit të letrës me ndihmën e aplikacionit të transformimit digjital. Për më tepër, Organizata planifikon instalimin e paneleve solare në zyrën qendrore për të promovuar edhe më tej efikasitetin energjetike.

Mbeturinat	Njësia	2021	2022	2023
Letër/karton	ton	10.15	12.00	8.59
Totali	ton	10.15	12.00	8.59
Konsumi i ujit	Njësia	2021	2022	2023
Uji i rrjetit	m ³	3,600	3,766	3,941
Ujëra nëntokësore	m ³	84	84	84
Totali	m³	3,684	3,805	4,025
Konsumi i energjisë	Njësia	2021	2022	2023
Energji elektrike	kWh	491,049	486,889	462,208
Totali	kWh	491,049	486,889	462,208

5.2. Vlerësimi i rrezikut mjedisor dhe social në aktivitetet e kredidhënies

Për të garantuar pajtueshmërinë me strategjinë e qëndrueshmërisë, ky vlerësim përmban Listë Përrjashtuese që është në përputhje me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), e cila përcakton aktivitetet që nuk do të financohen. Procedura e SMSM-së përcakton se sistemi i vlerësimit për kredidhënie zbatohet për të gjitha kreditë pa asnjë prag. Ky proces fillon me zyrtarin e kredisë, i cili përcakton nëse aktiviteti i propozuar i takon Listës Përrjashtuese. Më pas, projekti kategorizohet si me rrezik të ulët, të mesëm ose të lartë, në përputhje me udhëzimet e Kategorizimit të Projektit. Në varësi të kompleksitetit të projektit,

kryhet një vizitë në terren ose një rishikim i dokumenteve, dhe klienti vlerësohet kundrejt treguesve të rrezikut të mundshëm M&S dhe pajtueshmërisë rregullative, siç përcaktohet në dokumentin “Udhëzuesi dhe Lista e Kontrollit për Verifikimin e Projektit M&S”. Pas këtij vlerësimi, plotësohet Formulari i Vlerësimit M&S, duke shënuar përfundimin e procesit. Në përputhje me Procedurën e SMSM, çdo rast i mundshëm me rrezik të lartë kërkon monitorim të vazhdueshëm nga zyrtari MSQ, së bashku me hartimin dhe zbatimin e një plani të veprimit për zbutjen e atyre rreziqeve. Në periudhën vijuese, KEP Trust planifikon të rivlerësojë në mënyrë gjithëpërfshirëse rreziqet aktuale të kredive dhe portofolit të vet në aspektin e rrezikut M&S, për të përmirësuar vlerësimin e ekspozimeve.

5.3. Luftimi i ndryshimeve klimatike dhe synimet e ardhshme

Si një nga sfidat më të mëdha globale të kohës sonë, ndryshimet klimatike duhet të futen në agjendën e institucioneve financiare për shkak të pozitës së tyre të fuqishëm për të ndikuar në veprimet klimatike, përmes inkurajimit të projekteve dhe bizneseve të qëndrueshme që i japin përparësi uljes së gazeve serrë. Për të arritur këtë, KEP Trust monitoron rregullisht konsumimin e burimeve, përfshirë energjinë elektrike, ujin, letrën, materialet e shtypua dhe derivatet për flotën e saj të automjeteve në të gjitha lokacionet. Përpjekjet aktuale të qëndrueshmërisë përqendrohen në përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve të klimatizimit, aplikimit të izolimit të xhamave dhe uljen e përdorimit të letrës në të gjitha operacionet. Në përputhje me objektivat për të rritur eficientësinë e energjisë, KEP Trust gjithashtu planifikon të instalojë panele fotovoltaike në zyrën qendrore të tij, duke zvogëluar kështu edhe më tej gjurmën e tij të karbonit.

Përgjegjësia mjedisore e KEP Trust mbulon si zvogëlimin e gjurmës së vet, edhe kontributin në përpjekjet globale për të luftuar ndryshimet klimatike, duke integruar qasjen e qëndrueshmërisë mjedisore në operacionet dhe strategjitë e financimit. KEP Trust do të përqendrohet në zgjerimin e nismave që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë mjedisore, me një përkushtim afatgjatë në integrimin e qëndrueshmërisë në të gjitha aspektet e operacioneve të saj. Synimet e ardhshme përfshijnë krijimin e një Sistemi Operacional të Menaxhimit Mjedisor për të kontrolluar më mirë rreziqet mjedisore, për të vendosur caqe të matshme dhe për të përmirësuar aftësinë për të monitoruar dhe raportuar për performancën e qëndrueshmërisë. Synimet e ardhshme të qëndrueshmërisë së KEP Trust pasqyrojnë përkushtimin e vazhdueshëm ndaj përgjegjësisë mjedisore, duke kontribuar në një të ardhme më të gjelbër.

Si pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të KEP Trust ndaj qëndrueshmërisë dhe uljes së ndikimit të saj mjedisor, Organizata ka kryer një vlerësim gjithëpërfshirës

të gjurmës së saj të karbonit për vitin 2023, duke përfshirë zyrën qendrore dhe të gjitha degët e saj. Totali i emetimeve për këtë vit arrin në 1,052.56 tCO_{2e}, të shpërndara në tri fusha.

Së pari, emetimet e fushës 1, të cilat janë emetime të drejtpërdrejta që rezultojnë nga përdorimi i energjisë në hapësirat e KEP Trust, si konsumimi i lëndëve djegëse për gjeneratorë ose automjete në kontroll të drejtpërdrejtë nga Organizata, përbëjnë 161.54 tCO_{2e}. Emetimet e fushës 2 krijohen nga burime të tërthorta për energjinë elektrike të konsumuar në të gjitha lokacionet e KEP Trust. Kjo kategori përfaqëson pjesën më të madhe të gjurmës së karbonit të KEP Trust, duke kontribuar me 718.64 tCO_{2e}. Pavarësisht vëllimit në rritje vit pas viti të operacioneve, KEP Trust ka ulur emetimet e fushës 2 për 6% krahasuar me vitin 2021. Dhe në fund, emetimet e fushës 3, të cilat mbulojnë emetimet e tjera të tërthorta si ato nga udhëtimet për punë, asgjësimi i mbeturinave dhe aktivitete të tjera në zinxhirin e vlerës, arrijnë në 172.38 tCO_{2e}. Këto emetime, të cilat nuk kontrollohen drejtpërdrejt nga KEP Trust, janë thelbësore për t'u konsideruar si pjesë e përgjegjësisë mjedisore më të gjerë të KEP Trust.

Fushëveprimi	Sasia e emetimeve në 2023 (tCO _{2e})
Fusha 1: Emetime të drejtpërdrejta	161.54
Fusha 2: Emetime të tërthorta	718.64
Fusha 3: Emetime të tërthorta të tjera*	172.38
Totali	1.052.56

*Emetimet e financuara nuk janë përfshirë.



keptrust.org